



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e V-të

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 53/16

Prishtinë, më 19.4.2016, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Safete Hadergjona, Jelena Bontic, Adem Grabovci, Labinotë Demi-Murtezi, Besa Gaxherri dhe Fikrim Damka.

Munguan: Bardhyl Meta, Ilir Deda, Bali Muharremi dhe Enver Hoti

Pjesëmarrës të ftuar: Agim Krasniqi – Zëvendësministër i financave, Salvador Elmazi – Drejtor i Departamentit të Buxhetit në MF, Zahi Bajrami dhe Florije Morina nga Zyra e Kryeministrit.

Gjithashtu të pranishëm ishin: Agnesa Haxhiu – monitoruese nga KDI, Nehat Dervishi nga OSCE, Riorina Vjupi- gazetarë nga Birn, Albulena Mavraj- gazetarë nga Epoka e re,

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Isein, Luljetë Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 06.04.2016;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-067 për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë dhe amendamenteve të Komisionit funksional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-061 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës dhe amendamenteve të Komisionit Funksional për Punë të Jashtme;
5. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2015;
6. Shqyrtimi i Raportit financiar i Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2015;
7. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës për vitin 2015;
8. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2015;
9. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari – konstatoi se Komisioni miratoi rendin e ditës, pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalet nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 6.04.2016

Kryetari – konstatoi se procesverbali miratoheh pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-067 për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë dhe amendamenteve të Komisionit funksional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione

Kryetari – theksoi se Zyra e Kryeministrit si organ hartues i projektligjit, ka përgaditur vlerësimin e ndikimit buxhetor, ku është thënë se zbatimi i ligjit ka një kosto prej 5,412,000 euro. Për vitin 2017, 1,440,000 euro, janë paraparë për ministrin që zbaton ligjin, kurse 3,982,000 euro, nuk janë të parapara fare. Kjo shumë nuk është paraparë as në Kornizën Afatmëse të Shpenzimeve. Ne kemi të bëjmë me një ligj që trajton një kategori të ndjeshme sociale.

Agim Krasniqi – sqaroi se vlerësimet që janë bërë prej ministrisë së financave fillimisht kostoja shtesë është vlerësuar 3,972,000 euro, sepse ky ligj është vlerësuar nga viti 2017 dhe më vonë Zyra e Kryeministrit i ka bërë edhe disa kalkulime të reja për këtë projektligj dhe kostoja shtesë është 4,752,000 euro. Nenet që ndikohen në kuptimin financiar janë neni 7,14,15,16. Projektligji ka kaluar në qeveri me këtë vlerësim unë po du me e u njoftu se ky projektligj nuk është i paraparë në KASH për financim si buxhet shtesë. Në raste të tilla kur ministrat edhe ZKM-ja e aprovon një ligj të tillë e kanë obligim me implementue brenda ndarjeve buxhetore, përndryshe nuk ka mundësi për financim shtesë. Rekomandojë që mos me kalu ky projektligj pa një zotim të kryeministrit.

Kryetari - hartuesi i këtij ligji është kryeministria jo ministria e qështjeve sociale dhe i njëjti ka kaluar në qeveri. Ministri përkatës dhe ministria e financave është dashur në atë fazë të reagojnë. Natyra e ligjit ka të bëjë me një kategori të njerzve që kanë nevojën dhe përkujdesjen e shtetit dhe konsideroj që deputetët nuk kanë arsye mos me votue, përkundrazi kanë motiv për me i mbështet këtë kategori të njerzve. Qeveria ishte dashur mendojë mirë para se të dërgonte projektligjin në Kuvend.

Safete Hadërgjonaj - ne po përballemi me të njëjtin problem me vite të tëra, që prej vitit 2004 kur unë jam deputete dhe si ka mundësi në qeveri të kaloj projektligji që ka kosto buxhetore të papërfshirë në kuadër të kornizës afatmëse të buxhetit dhe të procedohet në Kuvend, dhe pastaj ne të përballemi me këto probleme. Tani kemi një projektligj shumë të ndjeshëm dhe ne si deputetë nuk mund të gjejmë fuqin me thënë se nuk e miratojmë e le të kthehet prapa, për shkak të kostos së madhe buxhetore. Krejt çka mundemi me thanë është se le të kalojë ligji e qeveria le ti gjejë mjetet për financimin e kësaj kategorie të personave, e që janë obligim i shteti që ta zgjedh këtë problem. Ne e dijmë se qfarë problemi kemi kaluar me ligjin për të verbërit. Unë nuk jam për mos me miratuar, dhe le të gjendet një zgjidhje me rishikimin e buxheti për pjesë të ndarjes së mjeteve e pjesën tjetër e shohim me buxhetin e vitit 2017.

Adem Grabovci – unë shprehi shqetësimin tim me qeverinë, që nuk është hera e parë që na qitni në këto situata të palakmueshme dhe në mënyrë absolute nuk do të lejojë asnjë deputet të grupit parlamentar dhe dhe në këtë rastë po flas edhe si shef i grupit, që ta kundërshtojë këtë ligj, përderisa qeveria e ka votuar dhe e ka përcjell në parlament. Ne po mundohemi me e mbajt situatën nën kontroll dhe e dijmë që ka shumë kategori që janë të paknaqura dhe tash me e nxit edhe një kategori tjetër. Nëse nuk ka mundësi buxhetore, nuk është dashur fare të hartoni projektligjin, por meqë ka ardhur në parlament, unë

nuk e jap votën time kundër, sepse kjo është një kategori tepër e ndishme dhe ato familje që përballen me këtë kategori janë tepër të ndishme.

Besa Gaxherri - unë pajtohem me koleget se qka u tha deri këtu, por realisht ne jemi një komision i buxhetit dhe financave dhe e kryejm punën teknikisht, në aspektin buxhetor, por deputetet janë edhe persona politik. Ne nuk po ndalemi këtu me vajtue se pse e bëri qeveria këtë sepse nuk është hera e parë që ndodh kështu me projektligje. Por ne nuk guxojm me e lëshue në këtë nivel situatën sepse qytetarët nuk din me e gjykue vetëm qeverinë por edhe neve sepse nëse aprovohet ligji ata kërkojnë mjete me iu nda dhe ti gëzojnë mjetet që ja cakton ligji. Ne e dimë realisht se qfarë situatë kemi me FMN-në, që tërheqin vërejtjen jo vetëm për këtë qështje por edhe për kategoritë tjera që financohen nga buxheti.

Kryetari - meqenë se mjetet për zbatimin e ligjit për vitin 2017 janë të parapara, për vitet në vazhdim të mendohet se kah do të sigurohen dhe unë jam me e qit ne votim të procedohet ne seancë me rekomandim që projektligji ka kosto të përballueshme për buxhetin e Kosovës.

Agim Krasniqi – në momentin kur është përgadit ky projektligj me situatën sot ka disa ndryshime në kuptimin edhe të presionit financiar dhe gjendjes fiskale. Unë ju kisha kërkuar mirëkuptimin tuaj që të diskutojmë edhe njëherë projektligjin në qeveri.

Kryetari – ne nuk mund të rekomandojmë kthimin në qeveri të projektligjit pasi që nuk jemi komision funksional, qeveria mundet në seancë plenare para votimit të tërheq projektligjin. Nëse e terhjek qeveria projektligjin, procedura shkon prej fillimit.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

1. Projektligji nr.05/L-067, për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, përmban kosto buxhetore të përballueshme për Buxhetin e Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional për Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, për Projektligjin nr.05/L-067, për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-061 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës dhe amendamenteve të Komisionit Funksional për Punë të Jashtme

Kryetari – sa i përket projektligji në fjalë që hartuar nga ministria e punëve të jashtme, në bazë të vlerësimeve buxhetore, kostoja shtesë buxhetore për vitet 2016-2018 është vlerësuar 851,400 euro apo 283,800 euro për një vit fiskal. Këto mjete nuk janë të parapara ne Kornizën Afatmesme. Kostoja shtesë ka të bëjë me shpenzimet për familjet e zyrtarëve që shërbejnë në misionet diplomatike jashtë Kosove. Është paraparë që një bashkshort/e të kompensohet 50% e pagës së koeficientit 7 të një shërbyesi civil, ndërsa një fëmijë të kompensohet 20% e pagës së koeficientit 7 të një shërbyesi civil

Agim Krasniqi – ne e kemi sqaruar në qeveri se qdo projektligj që miratohet dhe që ka kosto shtesë, ministria apo institucioni përkatës, duhet që brenda ndarjeve të brendshme buxhetore të zbatojë ligjin.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxorri këtë

R e k o m a n d i m

1. Projektligji nr.05/L-061, për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, përmban kosto buxhetore të përballueshme për Buxhetin e Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL për Punë të Jashtme, për Projektligjin nr.05/L-061, për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.
- 3.

Kryetari – konstatoi se në mungesë të korumit, pika tjera shtyhen për shqyrtim në një mbledhje tjetër të komisionit.

Mbledhja përfundoi në ora 12:00

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Naser Osmani